



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 62

Prishtinë, më 21.11.2012, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Mungoi: Rexhep Selimi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.10.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës, i cili u miratua pa ndryshime.

Tutje tha se nga mbledhja e kaluar është rënë dakord që në këtë takimet e radhë së Komisionit, të ftohet në dëgjim publik Ministri i Punëve të Brendshme, dhe propozoi datën 4 dhjetor 2012.

Gjithashtu tha se në këtë dëgjim publik, Ministri mund të raportoj për raportet të cilat i janë paraqitur Komisionit për ngjarjet e 17-18 tetorit, gjatë protestës së Lëvizjes Vetëvendosje dhe për situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës. Tutje përmendi paraqitjen e njësive ilegale në veri të vendit dhe se për këtë gjë do të pyetet Ministri.

Në përfundim të kësaj pike u ra dakord që me datë 4 dhjetor 2012, të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, i cili do të raportoj për raportet e paraqitura në Komision dhe situatën e Sigurisë në Kosovë.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.10.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.10.2012, i cili u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ia kaloi z. Marinkovič.

Goran Marinkovič- Tha se nuk ka marrë materialet në gjuhën serbe, të cilat i referohen kërkesës për buxhet nga ana e institucioneve që mbikëqyren nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Kryetari i Komisionit- Tha se me qëllim që të jenë në gjuhën serbe të gjitha dokumentet që vijnë nga agjencitë që mbikëqyren nga Komisioni, do tu bëhet kërkesë që dërgimi i materialeve që i drejtohen Komisionit të bëhet në të gjuhën shqipe dhe serbe. Gjithashtu tha se në këtë takim do të bëhet vetëm njoftimi për këto kërkesa drejtuar Komisionit, pasi shqyrtimi do të bëhet në një nga mbledhjet e radhës.

Fatmir Xhelili- Propozoi që shqyrtimi i kërkesave buxhetore nga institucionet që mbikëqyren nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, të mbetet për njërën nga mbledhjet e radhës. Gjithashtu tha se gjatë këtij shqyrtimi do të ishte e nevojshme posedimi i pasqyrave financiare të vitit 2012 për agjencitë që kanë bërë kërkesa shtesë për mjete financiare, me qëllim që të shihet se si është menaxhuar me paranë publike dhe se si është realizuar buxheti, në cilat vija është proceduar mirë dhe në cilat jo. Për këtë arsye propozoi që kjo temë të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Kryetari i Komisionit- Tha se për agjencitë të cilat kanë dërguar kërkesa buxhetore, do tu dërgohet kërkesë për dërgimin e pasqyrave financiare në Komision të vitit 2012.

Gjithashtu tha se nëse anëtarët janë dakord, mund të caktohet një grup punues për të parë se sa është realizuar buxheti nga agjencitë që mbikëqyrën nga Komisioni, dhe të shihen kërkesat e arsyeshme të tyre.

Në këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e realizimit të buxhetit nga ana e agjencive gjatë vitit 2012, me këtë përbërje:

Fatmir Xhelili, Kryesues, Anton Quni dhe Vjollca Krasniqi, anëtar.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Njoftoi anëtarët e Komisionit për vizitën studimore në Vjenë, e cila do të realizohet nga 9-13 dhjetor 2012, gjithashtu tha se për çështjet që do të diskutohen në këtë vizitë studimore, prite nga anëtarët që të kontribuojnë në to.

Tutje njoftoi për kërkesën e drejtuar Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nga deputeti, z. Danush Ademi. Për këtë kërkesë tha se nuk hynë në fushën e realizimit nga ky Komision, prandaj propozoi drejtimin e kësaj kërkesë institucioneve adekuate, pasi kërkesa ka të bëjë me ndarjen e pesëqind mijë(500.000) euro, për familjet romë, ashkali dhe egjiptas të cilët janë në kushte të vështira.

Për këtë qëllim, propozoi që kjo kërkesë të drejtohet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Financave, Komisionit për Buxhet dhe Financa, pasi Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, shqyrton buxhetin vetëm të agjencive që i mbikëqyr.

Danush Ademi- Tha se arsye se pse kjo kërkesë i është drejtuar këtij Komisioni është se, nga kushte e këqija në të cilat jeton komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas, rrezikohet jeta e tyre nga rrënimi i shtëpive. Tutje përmendi raste të tilla në Komunën e Gjakovës dhe Ferizajt dhe se këtë kërkesë e konsideron si preventiv që të mos ndodhin rrënimi i shtëpive dhe rrezikimi i jetës për këto komunitete.

Gjithashtu tha se këtë kërkesë e ka bërë në Kuvend dhe se buxheti që ndahet për komunitete nuk shfrytëzohet nga komunitetet, buxhet i cili u shpërndahet ministrive përkatëse, siç është Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, prandaj e konsideroi të nevojshme që Komisioni të njihet me këtë çështje.

Kryetari i Komisionit- Tha se në rast se autoritete përkatëse që janë kompetente të merren me këtë çështje, nuk i kryejnë obligimet, atëherë mund të reagoj Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Fatmir Xhelili- Për kërkesën e bërë Komisionit, tha se janë dy adresa që mund të drejtoheni dhe në varësi të problematikës. Në rast të rrëshqitjeve të mundshme në ato zona, mund të bëhet kërkesë Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, të cilët e bëjnë

vlerësimin e rrezikshmërisë. Ndërsa në rast të rrezikut nga gjallesat, tha se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë, është kompetent dhe se në rast të vlerësimit për ndërmarrjen e hapave mund të realizohet kjo. Prandaj konsideroi se në rast se këto institucione nuk merren me këtë problematik, janë organet e Kuvendit që mund të ndërmarrin iniciativa në këtë drejtim.

Goran Marinković- Për kërkesën e cila i është adresuar Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, tha se mbështet mendimin e Kryetarit se është adresuar gabimisht, pasi janë ministritë kompetente që merren me këtë çështje, siç janë Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, pasi këto institucione do të ofronin përgjigjeje më adekuate për këtë kërkesë. Gjithashtu tha se Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, do të adresonte këtë kërkesë më mirë. Në vazhdim tha se e përkrah kërkesën e paraqitur në Komision, por Komision nuk është kompetent për të shqyrtuar këtë rast, pasi janë ministritë e veçanta që merren me këto çështje.

Në përfundim të fjalës së tij, tha se nga vizita e cila është realizuar tek Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, është rënë dakord edhe vizita tek Kryeinspektori i IPK-së. Tutje pyeti nëse është mundësia e takimit të Komisionit me Kryeinspektorin e IPK-së, në mënyrë që ti shpalosen disa shqetësime nga ana e anëtarëve të Komisionit?

Kryetari i Komisionit- Tha se pas dëgjimit publik të Ministrit të Punëve të Brendshme, do të caktohet takimi kur Kryeinspektori i IPK-së, të raportoj në Komision, i cili mund ti përgjigjet çdo ankese që mund të jetë ndaj këtij institucioni.

Anton Quni- Për kërkesën drejtuar Komisionit nga z. Danush Ademi, tha se këtë kërkesë e kupton si të arsyeshme, pasi në rast të rrezikimit të jetës të një numri të caktuar të një komuniteti, duhet të jetë interesim i Komisionit, por jo në aspektin financiar, por përcjelljen e kësaj kërkesë tek institucionet përgjegjëse për vlerësimin e kësaj situatë. Prandaj vlerësoi si të nevojshme procedimin e kësaj kërkesë në mënyrë që institucionet, qoftë në nivelin ekzekutiv apo legjislativ ti ndërmarrin masat.

Kryetari i Komisionit- Tha se për kërkesën e cila është bërë në Komision, propozoi që fillimisht tu drejtohet institucioneve kompetente, pasi konsideroi se pas reagimit të këtyre institucioneve mund të reagoj edhe Komisioni, në rast të mos marrjes parasysh të kësaj kërkesë nga ana e tyre.

Danush Ademi- Tha se kërkesa i është drejtuar Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, gjithashtu edhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, ku për të cilën gjë duhet të gjendet një zgjidhje.

Fatmir Xhelili- Tha se pajtohet me propozimin e z. Quni, që procedimi i kësaj kërkesë si një informatë, për rrezikun e mundshëm që mund të ndodh, mund tu përcillet institucioneve përkatëse.

Kryetari i Komisionit- Tha se e rëndësishme është që të jemi të njoftuar dhe se kjo informatë mund tu përcillet institucioneve kompetente.

Fatmir Xhelili- Informoi anëtarët e Komisionit për punën e grupit punues për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë, gjithashtu theksoi se tani grupi punues është fokusuar në fusha të caktuar të mbikëqyrjes, për të cilën gjë është kërkuar edhe mbështetja e Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik, ku nga zyrtarët e tyre është ofruar ndihmë për monitorimin e disa lëndëve.

Tutje ftoi anëtarët e Komisionit që nëse kanë kërkesa për monitorimin e ndonjë segmenti të caktuar, mund të propozojnë si dhe ftoi anëtarët e Komisionit për kontributin e tyre në këtë grup. Duke vlerësuar se një proces i tillë do të dal me rezultate konkrete të monitorimit financiar ndaj institucioneve të sigurisë, gjithashtu propozoi takimin radhës të grupit punues me datë 23.11.2012.

Kryetari i Komisionit- E vlerësoi punën e grupit punues dhe tha se mund të jetë pjesë e këtij takimi, për të parë nga afër metodologjinë dhe lëndët e përzgjedhura për tu monitoruar.

Luanda Domi (zyrtare e projektit të DCAF)- Njoftoi për agjendën e vizitës studimore në Vjenë, të datës 9-13 dhjetor 2012, dhe kërkoi konfirmim për pjesëmarrje në këtë vizitë.

Kryetari i Komisionit- Kërkoi nga anëtarët që të konfirmoj shkuarjen ose mos shkuarjen në këtë vizitë studimore.

Vjollca Krasniqi- Tha se do të konfirmoj në ditët në vijim.

Fatmir Xhelili- Tha se nuk mund të jetë pjesë e vizitës studimore në Vjenë, të datës 9-13 dhjetor.

Kryetari i Komisionit- Ndërsa për konfirmimin e z. Rexhep Selimi, tha se konfirmimi i tij do të merret në ditët në vijim.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi